

KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS

Nr. 08-3658/2

16.12.2025

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 3-të e rregullt e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 16.12.2025 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 09:10.

Seancën në ora 09:10 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Ajhan Sulkoski, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Zhaneta Milanoska Petreska, Aleksandar Mickoski, Mihajlo Daniloski, Irena Naumoska, Violeta Stefanoska, Bojan Trajkoski, Dragan Dejanoski, Mirsad Ramazanoski, Ilir Rushani, Shefki Imeti, Latife Imani, Siarta Saliju Osmani, Asip Zendeli, Fadil Emini, Teuta Ahmedi Purellku , Kujtim Kasami, Beqir Osmani dhe Stevo Stefanoski.

Në seancë ishën të pranishëm: Sekretari i Komunës Aneta Nasteska, Valdet Selimi, Burim Kadriu, Lençe Srbinoska, Mite Dimitrijoski, Arben Ristemi - përfaqësues të administratës komunale,

Kryetari i Këshillit, pasi konstatoi se kishte kuorum për punë, për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Propozim Vendim për zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2025

Pasi konstatoi se nuk kishte pikë shtesë në rendin e ditës, Kryetari i Këshillit e vuri rendin e ditës të propozuar për këtë seancë për miratim dhe i njejt i miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kalohet në:

1. PIKA E PARË: Propozim Vendim për zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Burim Kadriu - Informoi se kjo seancë ishte urgjente, përshkak se duhej të sillet Vendim për zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2025, i cili iu është dorëzuar. Megjithatë, Vendimi kishte një ndryshim që iu dorëzua para fillimit të seancës, dhe i referohej faktit se Qeveria kishte miratuar një zgjerim të bllok-dotacioneve në Arsimin Fillor. Bllok-dotacionet për arsimin fillor kishin një rritje shtesë prej 13 milionë e 972 denarësh. Ai theksoi se të dhënat ishin mbledhur nga të gjitha shkollat dhe se këto mjete shtesë ishin propozuar të përdoren për: energji elektrike 2.000.000 den., lëndë djegëse të lëngshme 7.309.000 den., furnizime me materiale zyre 559.000 den., mirëmbajtje të ndërtesave të tjera 244.00 den., shërbime transporti për nxënësit 2.246.000 den., shpenzime të tjera operative 240.000 den., transfera të tjera 1.315.000 den. dhe blerje të mobiljeve për zyra 59.000 den. Ai informoi se sipas Ligjit, nëse këto mjete nuk do të shfrytëzoheshin deri në fund të vitit 2025, ato do të duhej të ktheheshin në buxhetin e shtetit. Prandaj, ishte e nevojshme të shfrytëzohen dhe të përdoren për nevojat e shkollave fillore.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2025 dhe i njejt i miratua unanimit me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Përshkak se askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe me këtë u shterë rendi i ditës për këtë seancë, ndërsa Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 09 e 20.

Procesverbalist

-Lenqe Srbinoska

Përkthyes:Tefik Asani

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Ajhan Sulkovski

